



Periodiku AMF

Mbi zhvillimin e Konferencës së 35-të Vjetore të IOSCO-s

(Material i përpunuar, nxjerrë nga Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO), qershor 2010)

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO), zhvilloi gjatë periudhës 6-10 qershor 2010, Konferencën e 35-të Vjetore, në Montreal, Kanada. AMF u përfaqësua në këtë eveniment nga zyrtarë të lartë të Institucionit, kryesuar nga Elisabeta Gjoni, Kryetare e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Vijon në faqen 2

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar - maj 2010

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar - maj 2010 arritën shifrën 3,311,495 mijë lekë, përkundrejt 3,287,799 mijë lekë të realizuara në janar - maj 2009 ose 0.72 % më shumë. Vihet re një ndryshim i strukturës së tregut të sigurimeve.

Vijon në faqen 3

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Zhvillohet takimi i rradhës së IOPS dhe Grupit të Punës së OECD për Pensionet Private

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS), në bashkëpunim me Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillim

Ekonomik (OECD), zhvilluan në Paris, Francë, gjatë periudhës 1-2 qershor 2010, takimet e mëposhtme:

- a) Grupi i Punës për Pensionet Private, OECD dhe Seminari për "Investimet alternative dhe derivativët", 1 qershor 2010.

Vijon në faqen 5

Zhvillohet takimi mbi mbikëqyrjen e fondeve të pensioneve

Banka Qendrore e Hollandës në bashkëpunim me Komisionin e mbikëqyrjes së sistemit të pensioneve private të Rumanisë zhvilluan gjatë periudhës 9-11 qershor 2010, në Bukuresht, Rumani, takimin mbi mbikëqyrjen e fondeve të pensioneve, eksperiencë nga Rumania dhe Holanda.

Vijon në faqen 6

Edukimi i konsumatorit

Përparësitë e një standardi global për aftësinë paguese

(Material i përpunuar, nxjerrë nga Geneva Papers, Vol. 35, nr. 1, 2010)

Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit i ofrojnë shërbimet dhe aftësinë e tyre për mbulimin e riskut jo vetëm në tregjet e tyre, por edhe në territore dhe juridiksione të tjera. Për t'i mbrojtur mbajtësit e policave në mënyrë të mjaftueshme, në një mjedis të tillë kompleks, duhet të ketë qasje mbikëqyrëse të sofistikuar.

Vijon në faqen 7

Në këtë numër:

Mbi zhvillimin e Konferencës së 35-të Vjetore të IOSCO-s	2
Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura	3
Ngjarje dhe zhvillime të tjera	5
Edukimi i konsumatorit	7

Mbi zhvillimin e Konferencës së 35-të Vjetore të IOSCO-s

(Material i përpunuar, nxjerrë nga Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO), qershor 2010)



Kryetarja e AMF-së, Zj. Elisabeta Gjoni dhe zyrtarë të lartë të Institucionit, gjatë zhvillimit të Konferencës

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO), zhvilloi gjatë periudhës 6-10 qershor 2010, Konferencën e 35-të Vjetore, në Montreal, Kanada. AMF u përfaqësua në këtë eveniment nga zyrtarë të lartë të Institucionit, kryesuar nga Elisabeta Gjoni, Kryetare e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Në konferencë u diskutua axhenda si më poshtë:

- Drejtimi Strategjik i IOSCO-s

Gjatë Konferencës së 35-të Vjetore, IOSCO e

riformuloi misionin dhe objektivin e saj strategjik për pesë vitet e ardhshme, për të marrë në konsideratë rolin e rritur të IOSCO-s në fushën e ruajtjes dhe përmirësimit të kuadrit rregullator ndërkombëtar të tregjeve të letrave me vlerë përmes vendosjes së standardeve ndërkombëtare, identifikimit dhe trajtimit të rreziqeve të sistemit, çuarjen përpara të përmirësimit të *Objektivave dhe Parimeve të Rregullimit të Letrave me Vlerë* të IOSCO-s, si dhe në ndjekjen e zbatimit të plotë të Memorandumit Shumëpalësh të IOSCO-s për Konsultimet, Bashkëpunimin dhe Shkëmbimin e Informacionit.

Grupi i Posaçëm i Punës për Drejtimin Strategjik të Komitetit Ekzekutiv është duke vazhduar shqyrtimin që po i bën rolit dhe funksioneve kyçe të IOSCO-s, në mënyrë që t'i japë mundësi IOSCO-s të vazhdojë udhëheqjen në përgatitjen e standardeve rregullatore për tregjet e kapitalit, duke mbajtur në konsideratë mësimet e nxjerra nga kriza financiare botërore.

- Përditësimi i *Objektivave dhe Parimeve të IOSCO-s*

Objektivat dhe Parimet e Rregullimit të Letrave me Vlerë të IOSCO-s (Parimet e IOSCO-s) janë miratuar nga kjo organizatë në vitin 1998. Objektivi i tyre është të nxisin vendet anëtare për përmirësimin e cilësisë së rregullimit që u bëjnë letrave me vlerë. Ato janë treguesit ndërkombëtarë të krahasimit, për parimet dhe praktikatat e duhura për rregullimin e tregjeve të letrave me vlerë.

Në situatën e krijuar pas krizës më të fundit financiare, Komiteti Ekzekutiv i IOSCO-s, i ngarkoi Grupit të Posaçëm të Zbatimit detyrën për të rishikuar Parimet e IOSCO-s, duke marrë në konsideratë konsensusin e arritur lidhur me shqetësimet rregullatore që ka nxjerrë në pah kriza. Komiteti i Kryetarëve ka miratuar parimet e rishikuara të IOSCO-s, ku përfshihen tetë parime të reja si edhe një sërë ndryshimesh në parimet ekzistuese.

Komiteti Ekzekutiv po vazhdon shqyrtimin, duke

u përqendruar tani në Metodikën për Vlerësimin e Zbatimit të Parimeve të IOSCO-s.

- Memorandumi Shumëpalësh i Mirëkuptimit të IOSCO-s

I miratuar në maj 2002, Memorandumi Shumëpalësh i IOSCO-s është standardi ndërkombëtar i krahasimit për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit mes enteve rregullatore. Gjatë kësaj mbledhje, IOSCO theksoi suksesin e arritur në përmbushjen e një objektivit ambicioz, të vendosur në vitin 2005, që të gjitha vendet anëtare të kërkonin ta nënshkruanin Memorandumin brenda datës 1 janar 2010.¹

Sot, 96% e 115 enteve rregullatore anëtare të IOSCO-s i përmbushin kërkesat e nevojshme për t'u bërë palë nënshkruese ose janë angazhuar për të bërë ndryshime legjislative, të cilat do t'u japin mundësi ta bëjnë një gjë të tillë.

- Nisma për ngritjen e standardeve për bashkëpunimin ndërkufitar

Nisma e Kontaktit e IOSCO-s me anëtarët që nuk kanë shumë rregullim apo që nuk janë bashkëpunues vijon të jetë një prioritet i punës dhe është arritur një progres i ndjeshëm me një sërë anëtarësh të cilët më parë nuk kanë qenë bashkëpunues. Objektivi i kësaj pune është të arrijë secilin prej juridiksioneve të identifikuara për të bërë përmirësime të vërteta në nivel të bashkëpunimit që mund t'u ofrojnë homologëve të tyre të huaj lidhur me shkëmbimin e informacionit.

- Raportet e miratuara për botim

Gjatë mbledhjeve të tyre, Komiteti Teknik dhe Komiteti i Tregjeve të Reja, finalizuan një sërë raportesh, të cilat do të botohen gjatë javëve në vijim.

¹ AMF është nënshkruese e MMoU-së me IOSCO-n që prej qershorit 2009

Vështrim mbi tregjet e mbikëqyrura

Vështrim mbi tregun e sigurimeve janar - maj 2010

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimeve për periudhën janar - maj 2010 arritën shifrën 3,311,495 mijë lekë, përkundrejt 3,287,799 mijë lekë të realizuara në janar - maj 2009 ose 0.72 % më shumë. Vihet re një ndryshim i strukturës së tregut të sigurimeve. Primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zunë 50.67% dhe ato të sigurimit të detyrueshëm 49.33% të tregut, ku në krahasim me vitet e mëparshme, primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zinin pjesën më të konsiderueshme të tregut. Përsa i takon rritjes së tregjeve, në veçanti, kemi një rritje në masën 5.80% të sigurimeve të Jetës dhe një ulje 0.03% të sigurimeve të Jo-Jetës. 90.32% e primeve u gjenerua nga sigurimet e Jo-Jetës, 9.09% nga veprimtaria e Jetës dhe 0.59 % nga risigurimi. Gjatë 5-mujorit të parë të vitit 2010 u nënshkruan rreth 246,169 kontrata sigurimi, ose rreth 17.62% më pak se në janar - maj të vitit 2009.

Sigurimet e detyrueshme


Në janar - maj 2010, sigurimet e detyrueshme motorike sollën 49.33% të të ardhurave nga primet e shkruara bruto të tregut të sigurimeve.

Primet e shkruara bruto të sigurimit TPL e brendshme, për 5-mujorin 2010, arritën 1,202,190 mijë lekë, ose 1.39% më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit 2009.


Në janar - maj 2010, primet e shkruara bruto të kartonit jeshil ishin 338,874 mijë lekë, ose rreth 34.76% më pak se në janar - maj 2009.

Primet e kontratës së sigurimit kufitar gjatë periudhës janar - maj 2010 arritën në 92,529 mijë lekë, apo 15.04% më shumë se në janar - maj 2009.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar-maj 2010




Struktura e tregut të sigurimeve, janar-maj 2010



Volumi i primit të shkruar bruto, janar-maj (2009-2010)

Lloji i sigurimit	Vlera (në mijë lekë)	
	2009	2010
Janar - Maj	2009	2010
A) Sigurim i Jetës	284,496	301,010
B) Sigurim i Jo-Jetës	2,991,900	2,990,966
a) Sigurimi i Detyrueshëm	1,785,553	1,633,593
b) Sigurimi Vullnetar (Jo-Jetë)	1,206,347	1,357,373
c) Risigurimi	11,403	19,519
TOTAL	3,287,799	3,311,495

Volumi i primit të shkruar bruto, janar-maj 2010 (Jeta dhe Jo-Jeta)



Sigurimet vullnetare

Në janar - maj 2010, të ardhurat nga sigurimet vullnetare arritën në 1,677,902 mijë lekë (përfshi dhe primet nga risigurimi), ose 11.69% më shumë se të ardhurat e të njëjtës periudhë të një viti më parë. Rritja e primeve në sigurimet vullnetare vazhdon të lidhet ngushtë me nivelin e kreditimit nga bankat dhe hyrjen e investitorëve të mëdhenj, kryesisht në infrastrukturë.

Në sigurimet vullnetare të Jo-Jetës, me të ardhura 1,376,892 mijë lekë (përfshi dhe primet nga risigurimi), vendin e parë e zunë sigurimet nga zjarri dhe rreziqet natyrore me rreth 32.32% të


pasuara nga, sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme civile me 23.94% dhe nga sigurimi kasko me 17.85%. Peshë më të ulët patën sigurimi i aksidenteve dhe shëndetit, sigurimet e garancisë, si dhe prime nga veprimtaria e risigurimit.

Të ardhurat nga sigurimet e aksidenteve dhe shëndetit, në janar - maj 2010, arritën në 173,470 mijë lekë, 0.24% më pak se në janar - maj 2009. Peshën më të madhe e mbajtën sigurimet e shëndetit në udhëtim me rreth 73.18% të të ardhurave të këtij grupi.


Primet në sigurimet e jetës në janar - maj 2010 arritën në rreth 301,010 mijë lekë, ose rreth 5.80% më shumë se në janar - maj 2009. Rritja në sigurimet e jetës është e lidhur ngushtë me rritjen e nivelit të kredidhënies dhe sigurimit të jetës për efekt kredie.

Ndarja e tregut midis shoqërive të sigurimit

Tregu shqiptar i sigurimeve të Jo-Jetës ndahet ndërmjet shoqërive të sigurimit: Sigal, Sigma, Insig, Atlantik, Interalbani, Albsig, Intersig dhe Eurosig. Sigal udhëhoqi tregun me 30.62% të primeve.



Aktivitetin e Sigurimit të Jetës e ushtruan kompanitë Sigal-Life, Insig dhe Sicred. Sigal-Life udhëhoqi tregun me 58.06% të primeve.



Dëmet

Totali i dëmeve të paguara bruto nga shoqëritë e sigurimeve në janar - maj 2010 kapi vlerën 827,487 mijë lekë, ose 26.14% më shumë se në janar - maj 2009. Për vetë strukturën e tregut të paraqitur më sipër, pjesa më e madhe e dëmeve të paguara u përket sigurimit motorik me 691,947 mijë lekë, apo 83.63% të totalit.

Ngjarje dhe zhvillime të tjera

Zhvillohet takimi i rradhës së IOPS dhe Grupit të Punës së OECD për Pensionet Private

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve (IOPS²), në bashkëpunim me Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD³), zhvilluan në Paris, Francë, gjatë periudhës 1-2 qershor 2010, takimet e mëposhtme:

- Grupi i Punës për Pensionet Private, OECD dhe Seminari për “Investimet alternative dhe derivativët”, 1 qershor 2010.
- Takimi i Komiteteve Teknike dhe Ekzekutive të IOPS-it në datat 1-2 qershor 2010.

Çështje me rëndësi që u diskutuan në panelin e ditës së parë ishin Projektet DC (skemat me

² The International Organization of Pension Supervisors

³ Organization for Economic Co-operation and Development

kontribute të përcaktuara). Temat kryesore ishin: skemat DC dhe risku i kapitalit human, si dhe komunikimi i përfitimeve dhe risqeve të skemave DC. Ekspertë dhe lektorë ndërkombëtarë, të ftuar, dhanë mendimet e tyre për këto çështje.

Në vazhdim të ditës së parë, në pjesën e dytë u zhvillua seminari në bashkëpunim me OECD-në: *“Investimet alternative dhe derivativet”*. Në fillim u dha një panoramë nga tregu nga ekspertë ndërkombëtarë. Folësit adresuan tre çështjet e mëposhtme sipas perspektivës/eksperiencës së vendit të tyre:

- Sa të rëndësishme janë investimet alternative dhe derivatet e tyre, si dhe menaxhimi i riskut në investimet e fondeve të pensioneve? Cilat janë sfidat me të cilat ata përballen? Cilat janë kërkesat e drejtimit strategjik për të siguruar një menaxhim eficient dhe efektiv të këtyre instrumenteve?
- Cilat janë problemet e vërejtura në këtë fushë si pasojë e krizës dhe a janë reflektuar ndryshimet e duhura në qeverisjen e fondeve të pensioneve? A ka pasur humbje të konsiderueshme si pasojë e këtyre ekspozimeve?
- A është i rëndësishëm roli i investimeve alternative për të ardhmen dhe ç'pikëpamje kanë mbikëqyrësit e fondeve të pensioneve për këto çështje?

Më pas u zhvilluan diskutime mbi këto çështje që sqaruan mjaft probleme të rëndësishme për temën.

Në ditën e dytë u zhvillua Mbledhja e Komitetit Teknik të IOPS-it. Në mbledhje u prezantuan të rejtat më të fundit në sistemin e pensioneve (Kenia, Irlanda, Meksika dhe Franca). I rëndësishëm ishte prezantimi i përbashkët nga sekretariati i IOPS-it dhe OECD-së mbi disa rishikime të strukturave të Toolkitit, u dhanë përfundimet e përmbajtjes së Toolkitit, si dhe u prezantua webside i Toolkitit. Gjithashtu, gjatë mbledhjes u bë prezantimi i draftit të përbashkët

të IOPS&OECD mbi disa praktika më të mira në fondet e pensioneve dhe menaxhimin e riskut, si dhe Raporti i CEIOPS mbi disa rregulla të menaxhimit të riskut dhe një rishikim i praktikave më të mira.

U vlerësuan shumë prezantimi nga autoriteti homolog i Turqisë në lidhje me mbikëqyrjen e skemave me kontribute të përcaktuara, si dhe prezantimi nga Holanda mbi indikatorët e humbjeve në zbatimin e politikave të investimit të fondeve të pensioneve.

Aktiviteti u karakterizua nga një interesim i pjesëmarrësve, adresim pyetje/përgjigje, gjë që përforcoi domosdoshmërinë e organizimeve të tilla në drejtim të njohjes dhe shkëmbimit të eksperiencave dhe praktikave me të mira.

Mbledhja e rradhës së Komitetit Teknik u mbyll me një raport mbi plotësimin e database të IOPS/OECD dhe me parashtrimin e axhendës së mbledhjeve të ardhshme të IOPS-it në harkun kohor 2-vjeçar.

Zhvillohet takimi mbi mbikëqyrjen e fondeve të pensioneve

Banka Qendrore e Hollandës në bashkëpunim me Komisionin e mbikëqyrjes së sistemit të pensioneve private të Rumanisë zhvilluan gjatë periudhës 9-11 qershor 2010, në Bukuresht, Rumani, takimin mbi mbikëqyrjen e fondeve të pensioneve, eksperiencë nga Rumania dhe Holanda. Gjatë takimit u trajtuan çështjeve të ndryshme në lidhje me mbikëqyrjen e sistemit të pensioneve në kuadër të krizës financiare, administrimit me efektivitet të fondeve, investimi i aseteve, etj.

Qëllimi i këtij takimi ishte të ofronte një forum për kërkim dhe diskutim me autoritete kompetente në lidhje me çështje si risku i menaxhimit të fondeve të pensioneve në kuadër të krizës financiare, prezantimi me legjislacionin në fuqi dhe njohja më në hollësi të sistemit

Rumun të pensioneve private.

Çështjet kryesore që u diskutuan në ditë e parë ishin:

- Principet e IOPS-it dhe përshtatja e sistemit të mbikëqyrjes në dritën e këtyre principeve;
- Vlerësimi financiar (metoda e menaxhimit të riskut financiar);
- Efektet e krizës financiare mbi investimet;
- Legjislacioni i sistemit të pensioneve dhe policat e sigurimit.

Gjatë trajtimit të këtyre temave rëndësi të veçantë ju kushtua menaxhimit të fondeve në kuadër të krizës financiare, ku si risi e sistemit Hollandez ishte marrja e shoqërive të nënkontraktuara për të menaxhuar fondet e pensioneve. Legjislacioni në fuqi lejonte një shoqëri menaxhimi fondesh pensioni të merrte një shoqëri të jashtme ose nënkontraktuar, për administrimi e fondeve ose investimin e tyre.

Gjatë ditës së dytë u diskutuan çështjet:

- Sistemi Rumun i pensioneve në perspektivën Evropiane;
- Efektet e krizës financiare mbi mbikëqyrjen.

Në përfundim të takimit, të gjithë pjesëmarrësit u ndanë në grupe punë dhe hartuan një politikë investimesh virtuale për fondin e pensionit. Ky organizim ju dha mundësinë të gjithëve të vendoseshin në pozitën e administratorëve të fondeve të pensioneve dhe të propozonin zgjidhje konkrete në lidhje me investimet më të përshtatshme të fondeve të pensioneve.

Edukimi i konsumatorit

Përparësitë e një standardi global për aftësinë paguese

(Material i përpunuar, nxjerrë nga Geneva Papers, Vol. 35, nr. 1, 2010)

Shoqëritë e sigurimit dhe të risigurimit i ofrojnë

shërbimet dhe aftësinë e tyre për mbulimin e riskut jo vetëm në tregjet e tyre, por edhe në territore dhe juridiksione të tjera. Për t'i mbrojtur mbajtësit e policave në mënyrë të mjaftueshme, në një mjedis të tillë kompleks, duhet të ketë qasje mbikëqyrëse të sofistikuar. Pra, nuk do të ishte në favor të mbikëqyrësve, siguruesve dhe risiguruesve dhe as në favor të mbajtësve të policave, nëse çdo territor vendos regjimin e vet mbikëqyrës. Vetëm një qasje mbikëqyrëse globale mund të përmbushë kërkesat e plota dhe do të siguronte që të ardhurat e të gjitha palëve të interesuara do të shpërndaheshin si duhet. Në këtë material bëhet një krahasim i regjimeve mbikëqyrëse në Evropë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pra në dy tregjet kryesore të sigurimeve. Analizat që bëhen këtu tregojnë se standardi Evropian i Solvency II shfaq shumë karakteristika që do të duhej të kishte edhe një standard të mundshëm të ardhshëm global për aftësinë paguese.

Terma kryesore: rregullimi i sigurimeve; standardi Evropian i Solvency II; vlerësimi ekonomik.

Hyrje

Shoqëritë globale të sigurimit dhe risigurimit e ofrojnë shërbimin e mbulimit të riskut jo vetëm në tregjet prej nga vijnë por edhe në shumë territore dhe juridiksione të tjera. Tani për tani, ato ushtrojnë aktivitet në kushte mbikëqyrjeje heterogjene, të karakterizuara nga një shumëllojshmëri kërkesash sasiore dhe cilësore për kapitalin e riskut, administrimin e riskut dhe dhënien e informacionit. Përkundër ekzistencës së njohjes reciproke të regjimeve rregullatore, çka e lehtëson një barrë të tillë, ekziston nevoja për një standard global të aftësisë paguese. Futja e një standardi të tillë do t'u jepte mundësi shoqërive të shpenzojnë më pak burime për përmbushjen e kërkesave raportuese rregullatore. Kjo do t'i bënte kërkesat lokale për kapitalin rregullator të krahasueshme, duke i hapur kështu rrugën vendosjes së rregullave të barabarta të lojës për të gjithë siguruesit. Ndër hapat e mëtejshëm drejt

një kuadri mbikëqyrës më homogjen do të ishte qasja e rregullimit të aftësisë paguese të grupimeve të shoqërive, së bashku me futjen e konceptit të kryembikëqyrësit përfshirë edhe krijimin e kolegjeve të mbikëqyrësve për grupimet e sigurimit dhe risigurimit. Më në fund, të gjitha çështjet e përmendura përbëjnë përfitime për mbajtësit e policave në tërësinë e ofertave dhe kushteve më tërheqëse.

Kriza financiare ia drejtoi vëmendjen botës jo vetëm nga sektori bankar por edhe nga sektori i sigurimit dhe risigurimit. Hë për hë, mungon një sistem mbikëqyrës global i aftë për t'i zbuluar çrregullimet e ardhshme të tregjeve financiare më herët apo për ta zbutur efektin negativ të situatave të krizës financiare. Mjedisi rregullator është i copëzuar dhe mbikëqyrësit kanë parapëlqyer të bëjnë zgjidhje specifike sipas çdo vendi. Tani për tani, hartuesit e politikave, mbikëqyrësit, investuesit dhe palët e tjera të interesuara kërkojnë një sistem i cili mund të ishte modeli për standardin e ardhshëm të aftësisë paguese. Evropa, me qasjen e saj përmes Solvency II, ndodhet në pozita të mira, lidhur me këtë aspekt, duke qenë se prezanton një rreth prej kornizave më të përparuara mbikëqyrëse (për shembull, vendosja e kërkesave për kapitalin e aftësisë paguese dhe të parimeve për caktimin e provigjioneve teknike) si edhe të parakushteve teknike (për shembull, detyrimet dhe kompetencat e autoriteteve mbikëqyrëse dhe kërkesat lidhur me sistemet e shoqërive për administrimin e riskut).

Jo vetëm ky sektor i ekonomisë dhe mbikëqyrësit në mbarë botën, por edhe politikanët tani janë duke mbrojtur idenë dhe duke kërkuar përmirësime në mjedisin mbikëqyrës. Për shembull, Grupi i Njëzetëshes (G-20), në kuadër të çrregullimeve të kohëve të fundit në tregjet financiare, ka deklaruar se “Do të marrim masa për të ngritur një kuadër më të fuqishëm, më të

njëtrajtshëm, mbikëqyrës dhe rregullator për sektorin e ardhshëm financiar, i cili do të mbështesë rritjen e qëndrueshme globale dhe do t'u shërbejë nevojave të biznesit dhe qytetarëve”.⁴

Ky material përqendrohet jo vetëm te krijimi i përgjithshëm i një fushe të barabartë loje në mbikëqyrjen e sektorit financiar, por edhe te ndryshimet në sektorin e sigurimit dhe risigurimit. Mes të tjerësh, temën e parë e kanë trajtuar edhe Flamée dhe Windels⁵. Kjo temë po diskutohet me shumë intensitet edhe nga mbikëqyrësit e sigurimeve në mbarë botën. Megjithëse ka disa ngjashmëri të caktuara midis sektorëve financiarë (për shembull, sektorëve të shërbimeve bankare, të sigurimeve dhe të tregtimit të letrave me vlerë) çka do të përbënte një arsye për futjen e një qasjeje globale të integruar, dallimet mes tyre nuk janë të papërfillshme. Pra, duket se është më mirë të fillohet me një qasje të përbashkët në fushën e rregullimit të sigurimeve. Tema e këtij studimi është trajtuar më parë, deri diku, nga autori Elderfield⁶. Kështu pra, objektivi kryesor i këtij materiali është të shikojë zhvillimet më të fundit dhe të parashtrojë argumente dhe shqetësime të tjera shtesë. Në pjesën në vijim bëhet një prezantim i zhvillimeve mbikëqyrëse në tregjet kryesore globale të sigurimit dhe risigurimit. Në pjesën pas saj, shtjellohen avantazhet dhe kërkesat e një standardi mbikëqyrës global, shikohen pasojat e mosfutjes së një standardi të tillë dhe flitet për rolin e mundshëm të Shoqatës Ndërkombëtare të Rregullatorëve të Sigurimeve (IAIS). Në pjesën e fundit bëhet një përmbledhje.

Informacion i përgjithshëm i zhvillimeve rregullatore aktuale

Aktualisht, po bëhen përpjekje dhe nisma të plota dhe të gjera në mbarë botën për të modernizuar dhe përmirësuar sistemet rregullatore. Diskutimi i të gjitha zhvillimeve do të dilte jashtë objektit të këtij studimi, kështu që vëmendjen do ta përqendrojmë te Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat, sa i takon vëllimit

⁴ G-20 (2009).

⁵ Flamée dhe Windels (2009).

⁶ Elderfield (2009).



të primeve kanë një pjesë të madhe të kapacitetit sigurues parësor dhe risigurues (mbi 70%, sipas vlerësimeve të "Munich Re"). Megjithatë, përmenden përciptazi edhe disa juridiksione të tjera.

Me futjen e Testit Zviceran të Aftësisë Pagueuse, Zvicra ka një rën prej qasjeve mbikëqyrësve më të përparuara, e cila mbështetet në risk dhe shfaq elemente të fuqishme të mbështetjes së grupit. Në lidhje me pranimin e qasjes mbikëqyrëse zvicerane, ka një akt-mirëkuptimi midis Komitetit të Mbikëqyrësve Evropianë të Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (CIOPS) ku thuhet se Zyra Federale Zvicerane e Sigurimeve Private (FOPI) mund të caktohet si drejtuese ose si bashkëmbikëqyrëse për mbikëqyrjen ndërkufitare të grupimeve të sigurimit dhe risigurimit me seli në Zvicër⁷.

Autoriteti Monetar i Bermudës (BMA) vazhdon të punojë për standardet e njohjes rregullatore të ndërsjelltë përmes hartimit të një kuadri për mbikëqyrjen e grupimeve, përmirësimit të standardeve të mbikëqyrjes dhe dhënies së informacioneve publike dhe vendosjes së standardeve për shqyrtimet cilësore të administrimit të riskut. Objektivi ambicioz i vënies në zbatim të një kuadri për mbikëqyrjen e grupimeve parashikohet të arrihet brenda vitit 2011⁸. Për më tepër, BMA ka hartuar një dokument orientues, i ngjashëm me Solvency II dhe po përgatitet aktivisht për të përmbushur kërkesat për fillimin e mbikëqyrjes globale të sigurimeve.⁹

Entet rregullatore në vendet aziatike, si Japonia, Koreja dhe Singapori, si edhe në Australi dhe Meksikë, i kanë bërë tashmë ose kanë filluar të bëjnë ndryshime në kuadrin e tyre rregullator. Në veçanti, kjo kërkon krijimin e sistemeve të mbështetura në risk.

⁷ FMN (2007).

⁸ BMA (2009).

⁹ BMA (2008).

¹⁰ Shih www.ceiops.eu për të ndjekur procesin e konsultimeve dhe të vënies në zbatim.

Fuqizimi i mjedisit mbikëqyrës evropian: Solvency II

Solvency II përbën punën e tanishme të Komisionit Evropian dhe të disa palëve të tjera të interesuara për modernizimin e sistemit të rregullimit të aftësisë pagueuse për siguruesit dhe risiguruesit në Bashkimin Evropian. Solvency II është hartuar për të zëvendësuar rregulloret ekzistuese evropiane, të strukturuar në formë të thjeshtë (Solvency I) me një sistem bashkëkohor të mbështetur në risk për mbikëqyrjen financiare. Kjo do të thotë largim nga qasja e mbështetur në norma drejt një rregullimi të mbështetur në parime, në të cilin risqet e shoqërive vlerësohen duke përdorur kritere të përshtatshme për riskun dhe të njëjta për të gjithë tregun, pra kritere ekonomike. Si rezultat, risqet mund të vlerësohen më sakt dhe më shpejt. Këto tipare tregojnë se Solvency II është i mirë për konsumatorët duke e vendosur në qendër të punës mbrojtjen e mbajtësve të policave.

Direktiva e Kuadrit të Solvency II (Niveli 1 i Procesit të Labfalussy-së) u miratua përfundimisht në maj 2009 nga Parlamenti Evropian dhe nga Këshilli i Çështjeve Ekonomike dhe Financiare. Nxjerrja e masave zbatuese të Nivelit 2, të cilat po përgatiten nga Komisioni Evropian, në bazë të këshillave të dhëna nga CEIOPS, përbëjnë hapin e radhës drejt zbatimit të suksesshëm në vitin 2012¹⁰. Industria dhe palët e tjera të interesuara iu përgjigjën valës së parë dhe të dytë të Materialeve Konsultative të CEIOPS-së në qershor dhe shtator, ndërsa vala e tretë pritet të publikohet në nëntor, ku përgjigjet priten në dhjetor. Me krizën financiare në sfond, duket se CEIOPS është duke i rritur kërkesat e përgjithshme dhe po përpiqet të fusë një kujdes dhe konservatorizëm të tepruar në kuadrin e Solvency II. Këto prirje është më mirë që të mos pranohen, duke qenë se bien ndesh me frymën fillestare të kuadrit të direktivës të Nivelit 1. Industria duhet ta ngrejë zërin tani dhe të flasë për shqetësimet që ka, për të ruajtur karakterin e parë të mbështetur te parimet, për të cilin duket se ekziston një rrezik gjithnjë e më i madh humbjeje. Nëse nuk ndryshon kursi që

propozon CEIOPS, do të lindë një sistem aftësie paguese dhe mbikëqyrjeje i cili do të vendosë një barrë tepër të madhe financiare dhe administrative mbi shoqëritë e këtij sektori dhe nuk do të arrijë të nxisë plotësisht sjelljen e duhur. Për pasojë, konsumatorët do të përballen me kosto më të larta të sigurimit, krahasuar me një situatë tjetër të ndryshme. Kjo duhet të vendosë në lëvizje kambanat për mbikëqyrësit evropianë, sepse nëse Solvency II merr këtë drejtim, atëherë kjo gjë mund të rrezikojë pozicionin e sektorit të sigurimeve dhe kushtet e barabarta të lojës me sektorët e tjerë financiarë. Siguruesit nuk duhen mbajtur përgjegjës për zhvillimet e krizës financiare, të cilën nuk e kanë shkaktuar ata dhe e cila sektorin e sigurimeve e ka prekur më pak se sektorët e tjerë.

Gjendja e tanishme e sistemit mbikëqyrës amerikan dhe nismat modernizuese që lidhen me të

Megjithëse Qeveria Federale e SHBA-së vazhdon të mbajë autoritetin kushtetues për rregullimin e biznesit të sigurimit dhe risigurimit, disa dekada më parë ajo ua ka kaluar këtë pushtet 50 shteteve. Për pasojë, secili shtet ushtron tani pushtet të pavarur mbikëqyrës mbi operacionet e shoqërive që ushtrojnë aktivitet sigurimi apo risigurimi brenda shtetit. Shoqëritë e licencuara në të gjitha shtetet duhet të përmbushin kërkesat licencuese dhe rregullatore në të 50 juridiksionet. Ky sistem është kritikuar gjithnjë e më shumë nga organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurim-risigurimeve, si një sistem jo eficient, i cili ka nevojë të modernizohet. Shumë prej tyre kanë kërkuar një qasje më të njëtrajtshme kombëtare për rregullimin. Tani për tani, secili mbikëqyrës merr pjesë si anëtar në Shoqatën Kombëtare të Komisionerëve të Sigurimeve (NAIC), një organizatë private e krijuar pjesërisht për të nxitur shkallën e duhur të njëtrajtshmërisë rregullatore mes shteteve. Mirëpo, për shkak të natyrës private që ka, NAIC i mungon forca për të vepruar si mbikëqyrës kombëtar apo për t'u

kërkuar shteteve të miratojnë standarde rregullatore të njëtrajtshme.

Përkundër mungesës së forcës juridike, NAIC ka luajtur një rol drejtues në hartimin e standardeve të njëtrajtshme të aftësisë paguese dhe në nxitjen që u jep mbikëqyrësve shtetërorë për t'i miratuar këto standarde. Në qendër të standardeve sasiore është Modeli i Kapitalit të Mbështetur në Risk (RBC), i cili është prezantuar në vitin 1994 nga NAIC¹¹. Ky model, i cili në përgjithësi është i njëtrajtshëm në të gjitha shtetet, siguron një standard të mjaftueshmërisë së kapitalit të lidhur me risqet kryesore të siguruesve dhe u kërkon siguruesve të heqin mënjanë një shtresë kapitali amortizuese për të ofruar siguri. Ka modele të veçanta RBC për sigurimin e jetës, të shëndetit dhe të dëmtimit të pronave dhe të personave. Formulatat përqendrohen te klasat kryesore të risqeve, që do të thotë, se kjo nuk është një qasje e plotë e bazuar në risk. Pagesat e veçanta mbështeten në faktorë dhe llogariten përmes shumëzimit të një faktori vëllimi bazë me faktorin e riskut përkatës. Agregimi i klasave të risqeve supozon se klasat e risqeve ose janë të pavarura ose janë tërësisht të varura, çka sjell si rezultat formën më të thjeshtë të metodës së kovariancës.¹² Ka një përdorim më të shpeshtë dhe që synon modele të brendshme (për shembull, modelimi i normave të interesit nga shuma vjetore fikse, apo një metodë e modelimit rastësor për shumat vjetore të ndryshueshme me pagesa të garantuara). Në raste të tilla duhet menduar përdorimi i masave mbrojtëse, si zbatimi paralel i skenarëve determinist standard, apo kërkesa që shuma përfundimtare e kapitalit nga modeli i brendshëm nuk duhet të jetë e ulët në mënyrë të paarsyeshme. Dhe, e fundit, shuma përfundimtare e kapitalit të riskut krahasohet me burimet e kapitalit në dispozicion të siguruesit për të nxjerrë informacionin lidhur me fuqinë e tij financiare, informacion i cili përkthehet në disa nivele të ndërhyrjes mbikëqyrëse.

Procesi mbikëqyrës në SHBA përfshin edhe kërkesat për kontrole periodike në vend të kryera

¹¹ Holzmüller (2009).

¹² Vaughan (2009).

nga rregullatori kompetent, analizë financiare në letër mbështetur në të dhënat e raportuara nga siguruesi dhe auditime të pavarura. Duke filluar nga viti 2010, do të ndiqet një metodë kontrolli e fokusuar te risku, e cila vendos në shenjë çështje të tilla si administrimi i riskut dhe drejtimi i riskut. NAIC ka hartuar procedura për bashkërendimin e kontrolleve në disa shtete, të cilat zbatohen nga shtetet e janë krijuar edhe procese të tjera të brendshme të NAIC për identifikimin dhe ndjekjen e siguruesve të zhvlerësuar. Për më tepër, siguruesit i depozitojnë pasqyrat financiare pranë NAIC dhe ky informacion i jepet mbikëqyrësit të çdo shteti. Dhënia e informacioneve rregullatore përfshin kërkesën e lartpërmendur për depozitim të pasqyrave financiare të cilat ruhen në një bazë të dhënash qendrore të NAIC. Ky informacion përdoret për të bërë krahasim vlerësues.

Pavarësisht kontributeve të konsiderueshme të NAIC për rregullimin e aftësisë paguese të sektorit të sigurimeve në SHBA, kriza financiare e kohëve të fundit ka sjellë kërkesa për një përmirësim të mëtejshëm të sistemit amerikan. Në përgjigje të këtyre kërkesave, në qershor 2008, NAIC shpalli Nismën Modernizuese për Aftësinë Paguese, synimi i së cilës ishte të hetonte “ide të reja dhe mundësinë për të krijuar një sistem të aftësisë paguese i cili të mbizotëronte globalisht”.¹³ Ndër fushat në të cilat është përqendruar vëmendja në këtë nismë janë kërkesat ligjore për kapitalin, mbikëqyrja e grupimeve dhe risigurimi.

Krahas Nismës Modernizuese për Aftësinë Paguese, Zyra e Thesarit e SHBA-së rekomandoi në raportin e saj “Për një strukturë rregullatore financiare të modernizuar”, botuar në vitin 2008, krijimin e një karte federale fakultative (OFC) për siguruesit.¹⁴ Ky propozim mbron idenë e krijimit të një sistemi me përgjegjësinë për themelimin,

licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen federale të siguruesve, risiguruesve dhe shitësve të sigurimeve (domethënë, të agjentëve dhe brokerave). Sipas këtij propozimi, OFC-ja nuk do të jetë e detyrueshme: siguruesit mund të vazhdojnë të zgjedhin rregullimin e tanishëm, të bazuar në shtetet, për të mos iu nënshtuar rregullimit në nivel qendror. Shtetet nuk do të kenë juridiksion mbi ato subjekte që zgjedhin të rregullohen në nivel federal.

Vetë NAIC ka miratuar kohët e fundit një propozim për modernizimin e rregullimit të risigurimit në SHBA, i cili ka rrjedhoja të ndjeshme si për risiguruesit amerikanë ashtu edhe për ata botërorë. Sipas propozimit të NAIC, risiguruesit që janë të organizuar dhe licencuar në juridiksione rregullatore joamerikane që i përmbushin kushtet do të mund të ofrojnë risigurim të besueshëm për siguruesit amerikanë pas certifikimit nga një mbikëqyrës amerikan që vepron si një portë e vetme hyrëse. Risiguruesi joamerikan do të mund të kërkojë certifikimin nga cilido shtet amerikan që është miratuar nga një agjenci federale (“Këshilli Shqyrtues i Mbikëqyrjes së Risigurimit”) që vepron si një mbikëqyrës lejues që i plotëson kushtet. Në mënyrë të ngjashme, risiguruesit me seli në SHBA do të lejohen të bëjnë biznes në të gjithë SHBA-në në përputhje me një licencë të lëshuar nga një “mbikëqyrës i vetëm i shtetit të origjinës”.

Ashtu sikurse edhe në rastin e propozimit të Zyrës së Thesarit të SHBA-së për një OFC, propozimi i NAIC për modernizimin e kuadrit rregullator të risigurimit do të kërkonte autorizimin ligjor federal.

Vijon në numrin tjetër...

Për këtë numër punuan:
E. Shehi, R. Guri, L. Lloji,
R. Eltari, E. Kokona

¹³ NAIC (2009).

¹⁴ Zyra e Thesarit e SHBA-së (2008).